

## **Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus+ KA 2, për projektin K-Force për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa mobiliteti për mësimdhënie dhe trajnim në kuadër të projektit K-Force Erasmus+ KA 2 në :

- Universitetin e Tuzlës, Bosnje dhe Hercegovinë (mësimdhënie);
- Universitetin Ss. Cyril and Methodius, Shkup (trajnim);

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

-Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

### **Bursat do të mbulohen nga fondet e projektit K-Force dhe do të përfshijnë:**

-Kompensim ditor;

-Kostot e udhëtimit;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

-Universiteti i Tuzlës, Bosnje dhe Hercegovinë: 5 + 1 ditë;

- Universiteti Ss. Cyril and Methodius, Shkup: 12 + 1 ditë;

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor: (UNTZ-100 EUR/ day; UKIM - 120 EUR/day);

- Kostot e udhëtimit: ( 180 EUR );

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie/trajnim:**

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Anglisht);

- Letër mbështetëse nga koordinatori i projektit K-Force;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie/trajnim\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf)

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

\*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

#### **Afati për aplikim: 04 Shkurt 2019**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al) me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikoni.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!